

# Cenueshmëria nga Covid-19 në Ballkanin Perëndimor

## Perspektivë në Nivelin e Firmave<sup>1</sup>

- Pavarësisht ndryshimeve midis ekonomive të Ballkanit Perëndimor, duke iu referuar thjesht peshës që zinin të punësuarit dhe pagat e sektorit formal në ekonominë e vendit në tërësi para fillimit të krizës, rezultoi se sektorët që pritet të preken më shumë nga kriza Covid-19 janë turizmi dhe shërbimet e lidhura me të, si dhe industria e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm përfshirë eksportet.
- Anketat e zhvilluara në fillim të krizës tregojnë se firmat kanë arritur të amortizojnë në një masë të konsiderueshme goditjet. Deri më tani, pak firma kanë kryer pushime nga puna. Sidoqoftë, numri total i pushimeve nga puna të raportuara është mjaft i lartë, por ndoshta më i vogël nga sa mund të pritej. Politikat e ndjekura për zbutjen e efekteve të krizës mund të kenë luajtur rol në këtë drejtim<sup>2</sup>.
- Deri më tani, ndikimi në ekonomi ka qenë i konsiderueshëm, kryesisht përse i përket kërkesës. Të dhënat e anketave tregojnë se të paktën 50 për qind e firmave në sektorët më të prekur nga kriza në secilin prej vendeve u detyruan të ndërpresin aktivitetin, ndërsa ato që vijuan të qëndrojnë hapur përjetuan rënie të ndjeshme të tij. Ndikimi kryesor në të gjitha vendet e rajonit ka qenë rënia e kërkesës. Krahas kësaj, kufizimet e likuiditetit përbëjnë një shqetësim madhor kudo, megjithëse aftësia e sektorit financiar për të kompensuar këtë mangësi ndryshon sipas vendit.
- Nga anketat e kryera konstatohet se problemet në anën e ofertës kanë qenë relativisht më pak të rëndësishme. Për shembull, aksesin në lëndët e para dhe importet ka qenë problem më pak i shpeshtë krahasuar me probleme të tjera të krijuara nga kriza si rënia e kërkesës, kufizimet e likuiditetit dhe pasiguria. Derisa goditje të këtij lloji në anën e ofertës janë më të rëndësishme për industrinë prodhuese sesa për atë të shërbimeve, dhe nëse kjo mënyrë ndikimi është përfaqësuese për të gjitha firmat dhe nuk do të ndryshojë, atëherë një nga implikimet mund të jetë që prodhimi do të goditet më pak krahasuar me shërbimet (p.sh. turizmin).

## Hyrje

**1. Pandemia Covid-19 dhe masat e distancimit social pritet të shkaktojnë dëme të shumta për ekonominë në mbarë botën.** Kufizimet në lëvizje kanë çuar në zvogëlim të kërkesës, ndërsa ka patur gjithashtu goditje në anën e ofertës si rezultat i ofertës së kufizuar të punës si dhe për shkak të vështirësive në sigurimin e lëndës së parë. Aksesin në financim mund të kthehet gjithashtu në problem në rast se alternativat e kreditimit do të përkeqësoheshin ndërkohë që kërkesa rritet. Së fundmi, pasiguria që shoqëron krizën po çon në ulje të investimeve dhe inovacionit. Shkatërrimi i bizneseve normalisht të shëndetshme për shkak të reagimit ndaj goditjeve të tilla të përkohshme tregon për kosto të rënda sociale dhe fiskale

<sup>1</sup> Ky dokument është përgatitur nga Besart Avdiu, Elwyn Davies, Tianyu (John) Dong, dhe Raha Shahidsaless. Ekipi ka përfituar nga kontributet e Marc Schiffbauer, Edith Kikoni, Ruvejda Aliefendic, Keler Gjika, Sanja Madzarevic-Sujster, Bojan Shimbov, Dusko Vasiljevic, Tatjana Markovska, dhe Maja Andjelkovic.

<sup>2</sup> Studimi i impaktit të këtyre politikave është jashtë objektit të këtij dokumenti.

**2. Ky raport trajton brishtësinë ekonomike ndaj krizës së Covid-19 në vendet e Ballkanit Perëndimor – Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë (BH), Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi.** Fillimisht, dokumenti paraqet një përmbledhje për rajonin dhe më pas vijohet me analizën e vendeve. Raport kombinon dy qasje:

- a. Së pari, secili seksion i raportit për vendet fillon me një parashikim i cili analizon pasojat e mundshme të krizës duke përdorur të dhëna administrative në nivel firme, me përjashtim të Shqipërisë, ku në mungesë të të dhënave administrative, janë përdorur të dhëna shumë të besueshme nga vërtetimi strukturor i bizneseve. Të dhënat në nivel firme të nevojshme për këtë vlerësim nuk ishin të disponueshme për Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën. Ky studim përcakton nga pikëpamja sasore rëndësinë ekonomike të sektorëve që priten të goditen më rëndë nga mbyllja e aktivitetit dhe kufizimet e vendosura mbi ekonominë. Rëndësia ekonomike përcaktohet bazuar në peshën në përqindje të numrit të të punësuarve në çdo sektor dhe faturën përkatëse të pagave në ekonominë e përgjithshme para krizës. Ky seksion përqendrohet në sektorë “të ndjeshëm”, duke përfshirë por jo vetëm, shërbime të ndryshme, mallra të qëndrueshme dhe tekstile. Këto shërbime konsiderohen të ndjeshme pasi ofrimi i tyre është reduktuar dukshëm për shkak të mbylljes së ekonomisë<sup>3</sup>.
- b. Së dyti, duke përdorur të dhënat e anketimit të firmave të kryer gjatë krizës (me përjashtim të Malit të Zi për të cilin nuk ka të dhëna), raporti analizon provat e pakta të disponueshme mbi ndikimet që kanë ndodhur aktualisht. Analiza përqendrohet në katër kanale të mundshme të transmetimit të efekteve që janë me rëndësi për këtë vlerësim: goditjet në anën e kërkesës, goditjet në ofertë, goditja financiare dhe pasiguria. Ndërsa të katër kanalet analizohen në përmbledhjen e rajonit në bazë të të dhënave të anketave, seksionet specifike të vendeve paraqesin detaje vetëm për transmetimin e efekteve të krizës nëpërmjet kanaleve të kërkesës dhe ofertës.<sup>4</sup>

**3. Ky raport mbështetet në një larmi burimesh të të dhënave që janë objekt i kufizimeve të caktuara.** Këto kufizime janë të aplikueshme si për analizën e të dhënave administrative në nivel firme ashtu edhe për anketat në nivel vendi të kryera gjatë krizës:

- a. Të dhënat administrative mbulojnë vetëm bizneset e regjistruara në administratën tatimore duke përjashtuar në këtë mënyrë bizneset joformale të cilat mund të jenë edhe më të ekspozuara ndaj krizës. Më tej, duke qenë se ky seksion përcakton mundësinë që një sektor i caktuar të preket nga kriza bazuar në peshën që ai zë në ekonominë e përgjithshme të vendit përse i përket punësimit dhe faturës së pagave, ai nuk shqyrton domosdoshmërisht

---

<sup>3</sup> Aneksi 1 përmban klasifikimin e shërbimeve të ndjeshme, sipas Vavra (2020). Mallrat e qëndrueshëm konsiderohen gjithashtu të ndjeshme, për shkak se gjatë krizave kërkesa për këto mallra ka tendencë të bjerë në kolaps. Megjithëse tradicionalisht veshjet dhe tekstilet nuk konsiderohen mallra të qëndrueshëm, ato mund të preken po njëllonj pasi ato nuk janë për konsum imediat. Për Shqipërinë dhe Serbinë, raporti përdor gjithashtu të dhëna për eksportet, të cilat japin më shumë informacion rreth cenueshmërisë ndërkohë që kërkesa globale po bie dhe rrugët tregtare janë ndërprerë.

<sup>4</sup> Është e vështirë të bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë midis pjesës së parë (perspektivës) dhe pjesës së dytë (të dhënat e anketës së firmave gjatë krizës) të analizës, ndonëse të dyja plotësojnë njëra-tjetrën. Një arsye është se në pjesën e parë sektorët klasifikohen në nivel kodit 4-shifror, por anketat kryesisht kërkojnë të dhëna rreth sektorëve agregatë me kod një shifror. Ndonëse rezultatet e anketimit, të përdorura në pjesën e dytë të raportit, janë me vlerë dhe japin informacion rreth ndikimeve të krizës mbi firmat, nuk mundet që thjesht të mbështetemi tek ato sepse anketat e vendeve nuk janë domosdoshmërisht përfaqësuese ose të krahasueshme - dhe arsyet përse ato nuk janë përfaqësuese variojnë sipas vendit dhe metodologjive, të cilat në disa raste nuk janë të përsosura. Megjithatë, këto janë të vetmet të dhëna aktualisht të disponueshme. Të dhënat në pjesën e parë janë më të krahasueshme sepse ato mbulojnë të gjitha firmat.

sektorët që mund të ndikohen nga kriza përmes kanaleve të tilla siç janë goditjet në zinxhirin global të vlerës (psh për sektorët që mbështeten fuqimisht në importe) ose tronditjet financiare për sektorët që varen nga financimet e huaja.

- b. Në analizat e vrojttimeve janë përdorur të dhënat e anketimeve të kryera nga organizatat vendase, të tilla si shoqatat e biznesit,<sup>5</sup> të cilat mund të mos jenë përfaqësuese të vendit për shkak se disa sektorë apo firma të caktuara mund të jenë mbipërfaqësuar. Për këtë arsye, në Aneks 2 kemi dhënë edhe shpërndarjen e të anketuarve sipas sektorëve. Për më tepër, ekzistojnë dallime të dukshme në metodologjitë e zgjedhjes së kampioneve të cilat e bëjnë të vështirë krahasimin midis vendeve. Megjithatë, të gjitha anketat kanë disa rezultate të përbashkëta, të cilat bëjnë të mundur nxjerrjen e disa përfundimeve të zbehta

## 1 Analiza Rajonale

### 1.1 Analiza e Perspektivës


**4. Ekzistojnë disa dallime të dukshme midis vendeve në lidhje me sektorët më të cenueshëm ndaj efekteve të Covid-19, siç janë shërbimet kundrejt industrisë prodhuese.** Serbia dhe Mali i Zi qëndrojnë në skajet e kundërta të spektrit. Nisur nga numri i të punësuarve, ka të ngjarë që sektori më i prekur në Serbi të jetë industria e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm, ndërsa në Mal të Zi do të jenë kryesisht shërbimet, veçanërisht turizmi. Kjo shpjegohet kryesisht me faktin që 19 për qind e fuqisë punëtore në Serbi është e punësuar në prodhimin e mallrave të qëndrueshëm dhe 26 për qind në prodhimin për eksport, ndërsa në Mal të Zi, vetëm 5.7 për qind janë të punësuar në industrinë prodhuese. Ndërkohë, numri i të punësuarve në sektorin e shërbimeve në Mal të Zi është 23.4 për qind krahasuar me vetëm 7.8 për qind në Serbi (Figura 1). Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë një model disi më të përzier: Shqipëria mund të presë një barrë më të madhe mbi shërbimet, pasi vetëm akomodimi dhe shërbimet ushqimore punësojnë 13.4 për qind të fuqisë punëtore. Nga ana tjetër, 20.6 për qind e fuqisë punëtore në Maqedoninë e Veriut është e punësuar në industrinë e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm dhe veshjeve. Vlera totale e pagave në rrezik në sektorët e shërbimeve, prodhimit të mallrave të qëndrueshëm, veshjeve dhe tekstileve është gjithashtu e lartë, duke filluar nga 110 milionë euro (Mal të Zi) në 2.22 miliardë euro (Serbi) (Figura 2). Me heqjen e kufizimeve, ka mundësi që industria prodhuese të rifillojë aktivitetin përpara disa sektorëve të rëndësishëm të shërbimeve siç është turizmi. Në këtë rast, efektet në Mal të Zi dhe Shqipëri mund të jenë më afatgjata.

**5. Pjesa më e madhe e bizneseve në sektorët më të prekur kanë më pak se 50 të punësuar.** Përfundimisht bën vetëm industria e veshjeve dhe tekstileve në Maqedoninë e Veriut, ku firmat e vogla përbëjnë rreth 46 për qind të të gjithë bizneseve. Megjithatë, firmat e vogla në sektorët potencialisht të prekshëm përbëjnë mesatarisht 72 për qind të ekonomisë së Maqedonisë së Veriut në tërësi, 88 për qind në Serbi dhe Shqipëri, dhe 92 për qind në Mal të Zi.

---


<sup>5</sup> Ne kemi përdorur një anketë për çdo vend, me përjashtim të Maqedonisë së Veriut, për të cilën ishte e nevojshme të mbështeteshim në tre të tilla.

**Figura 1. Të Punësuarit në Sektorët e Mbyllur dhe me Kërkesë të Ulët, Përqind**



Burimi: Të dhëna në nivel firme, 2016 dhe 2017, Përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

**Figura 2. Fatura Totale për Paga në Sektorët e Mbyllur dhe me Kërkesë të Ulët, milion €**



Burimi: Të dhëna në nivel firme, 2016 dhe 2017, Përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

## 1.2 Vrojtimet Aktuale

**6. Bizneset në Ballkanin Perëndimor kanë pësuar humbje të konsiderueshme të të ardhurave për shkak të krizës së Covid-19.** Nga të dhënat e anketave të vendeve të mbledhura gjatë periudhës së krizës, të paktën 50 për qind e firmave në secilin nga vendet e rajonit ishin të detyruara të mbyllnin të paktën pjesërisht aktivitetin, ndërsa për ato që qëndruan hapur, biznesi ishte minimal. Dy tendenca dallohen qartësisht:

- Firmat mikro dhe të vogla u goditën më rëndë se firmat e mesme dhe të mëdha. Për shembull, pjesa e firmave mikro në Bosnjë-Hercegovinë që raportuan rënie të ndjeshme të të ardhurave ishte më shumë se 12 pikë përqindje më e lartë se mesatarja e gjithë firmave. Për më tepër, 35 për qind e firmave mikro në Serbi presin rënie të të ardhurave mbi 80 për qind krahasuar me 10 për qind të firmave të mesme me të njëjtën pritsmëri.
- Spektori i shërbimeve dhe turizmit pritet të ketë edhe pasojat më të rënda krahasuar me pjesën tjetër të ekonomisë. Në Shqipëri, pjesa e firmave që raportoi rënie të kërkesës si problemin kryesor ishte më e madhe në sektorin e turizmit se në sektorët e tjerë, ndërsa në Serbi humbjet në sektorin e turizmit pritet të jenë më të mëdha se në çdo sektor ku 45.5 për qind e firmave të turizmit presin që realizojnë 80–100 për qind më pak të ardhura krahasuar me 2019-n.

**7. Zvogëlimi i kërkesës së tregut raportohet si sfida numër një në të gjitha vendet.** 71 për qind e të anketuarve në Bosnjë-Hercegovinë dhe 81 për qind në Maqedoninë e Veriut janë prekur ndjeshëm nga rënia e kërkesës, e cila ka shkaktuar humbje të të ardhurave jo vetëm si rezultat i rënies së numrit të porosive të reja, por edhe për shkak të anulimit të porosive të mëparshme.

**8. Në krahasim me kërkesën, tronditjet e ofertës, midis të tjerave kufizimet në punë dhe lëndë të para, kanë qenë relativisht më të buta.** Për shembull, vetëm 15 për qind e firmave shqiptare e shohin çështjen e furnizimit si sfidën e tyre kryesore. Dhe sigurimi i lëndëve të para të nevojshme për prodhim është përmendur si shqetësim nga vetëm 13.8 përqind e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut dhe 10.4 për qind në BH.

**9. Firmat në të gjithë rajonin po vuajnë si rezultat i kufizimeve të likuiditetit.** Rreth 56 për qind e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut dhe 63 për qind e të anketuarve në BH e konsiderojnë mungesën e likuiditetit si problemin e tyre kryesor. Ndërsa për të anketuarit në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë ky është përgjithësisht problemi i dytë më i raportuar.

**10. Të dhënat lidhur me faktin nëse bizneset do të kërkojnë kredi të reja apo do të rinegociojnë kreditë aktuale variojnë sipas vendeve.** Për shembull, vetëm 20 për qind e të anketuarve në Shqipëri dhe 4.2 për qind në Maqedoninë e Veriut e shohin marrjen e kredive të reja si opsion, ndërsa 40 për qind e firmave në Bosnjë-Hervcegovinë do ta bënin këtë, dhe 30 për qind e firmave serbe mund ta bëjnë këtë.<sup>6</sup>

**11. Pritshmëritë për të ardhmen gjithashtu variojnë ndjeshëm; Për Shqipëri dhe BH ato janë më pesimiste.** Mbi 80 për qind e firmave të anketuara në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut besojnë se efektet e krizës së Covid-19 do të zbehen në më pak se tre muaj, por më pak se 50 për qind e firmave në Shqipëri dhe BH ndajnë këtë mendim. Ndër vendet më optimiste për një rimëkëmbje të shpejtë janë Serbia, ku 80 për qind e bizneseve shpresojnë të rifillojnë aktivitetin brenda gjashtë muajve, dhe Maqedonia e Veriut, ku 72 për qind e tyre nuk e kanë menduar mbylljen e kompanisë. Në të kundërt, vetëm 10 për qind e të anketuarve në BH shpresonin që bizneset e tyre t'i mbijetonin krizës, dhe 60 për qind e firmave të anketuara në Kosovë mendojnë se Covid-19 ka vënë në rrezik mbijetesën e tyre.

**12. Deri tani, firmat në të gjitha vendet e rajonit kanë mundur të amortizojnë ndikimet nga kriza pa largime nga puna.** Vetëm një numër i vogël i firmave kanë zgjedhur të kryejnë largim të detyruar apo pushim nga puna të punonjësve: 5 për qind në Serbi, 11 për qind në Shqipëri dhe BH, 19.8 për qind në Maqedoninë e Veriut dhe 29.2 për qind në Kosovë. Si rrjedhojë, efektet negative në punësim mund të përkeqësohen më tej.

## 2 Shqipëria

### 2.1 Analiza e Perspektivës

**13. Bazuar në faturën e pagave dhe punësimin, kriza e shkaktuar nga Covid-19 pritet të godasë ekonominë shqiptare kryesisht nëpërmjet sektorëve të lidhur me turizmin dhe prodhimin e veshjeve dhe tekstileve.** Përveç kësaj, duke qenë se kërkesa për mallra të qëndrueshëm ka prirje të bjerë gjatë krizave, atëherë pritet që efektet e krizës të ndihen edhe në prodhimin e këtyre mallrave. Për shkak se produktet e tyre janë të një natyre gjysëm të qëndrueshme dhe duke qenë se ato punësojnë pjesën më të madhe të krahut të punës, firmat e veshjeve dhe tekstileve do të jenë një nga sektorët më të goditur të industrisë prodhuese, veçanërisht bizneset e veshjeve dhe këpucëve të cilat zënë një pjesë të madhe të eksporteve. Pjesa e përgjithshme e faturave të pagave dhe punësimit në sektorët e cenueshëm përfshijnë si më poshtë:

- a. **Në vitin 2016, pjesa e përgjithshme e punësimit formal në sektorët që pritet të preken drejtpërdrejt nga masat e izolimit ishte 30.4 për qind (142.750 nga 469.600 të punësuar).** Nga këto, 13.4 për qind ishin në sektorë të lidhur me turizmin – ushqim, akomodim, udhëtim dhe transport. Nëse do të shtonim prodhuesit e mallrave të qëndrueshëm, si dhe firmat e prodhimit të veshjeve dhe tekstileve - të gjithë sektorë të prekur nga kriza, por që jo domosdoshmërisht kanë ndërprerë aktivitetin – atëherë pesha e këtyre sektorëve në punësimin total shkon në 45 për qind.
- b. **Në vitin 2016, fatura totale e pagave në aktivitetet e mbyllura përbënte 24 për qind të vlerës totale të pagave në nivel kombëtar, 290 milionë euro, ose një pagë mesatare vjetore prej 1,190 euro.** Përtej sektorëve që kanë ndërprerë aktivitetin si rezultat i krizës, rezultatet janë më shqetësuese për të gjithë sektorët e ndjeshëm (mallra të qëndrueshëm dhe tekstile): fatura totale e pagave në sektorët e prekur përbën 38 për qind të totalit të pagave të Shqipërisë (459 milionë euro nga 1.2 miliardë euro).

---


<sup>6</sup> Për Kosovën nuk ka të dhëna të disponueshme për aksesin në financim.

## 2.2 Vrojtimet Aktuale <sup>7</sup>

**14. Operacionet e biznesit janë në gjendje kritike, por megjithatë nuk ka patur shumë largime nga puna.** Sipas anketës së Sekretariatit të Këshillit të Investimeve<sup>8</sup>, kriza e Covid-19 ka shënuar rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik, ku gjysma e firmave të anketuara kanë deklaruar se kanë ndërprerë tërësisht aktivitetin. Pavarësisht kësaj, siç tregohet në Figurën 3, deri më tani vetëm 11 për qind e firmave kanë bërë shkurtime nga puna, 28 për qind e tyre i kanë lejuar punonjësit të punojnë nga shtëpia, ndërsa 13 për qind e firmave kanë përdorur dhënien e lejes vjetore.


**15. Reduktimi i kërkesës për mallra dhe shërbime është një nga sfidat më të mprehta me të cilën po përballen firmat aktualisht.** 25 për qind e të anketuarve janë shprehur se problemi i tyre kryesor është mungesa e klientëve (figura 4). Ky ndikim negativ në kërkesë është më i theksuar në sektorin e shërbimeve (27 për qind) dhe ndërtimit (26 për qind) krahasuar me prodhimin (16 për qind) ose bujqësinë (17 për qind). Pavarësisht mungesës së theksuar të likuiditetit, për të garantuar vazhdimësinë e aktiviteteve të biznesit, rreth 69 për qind e firmave kanë planifikuar të përdorin rezervat e tyre të të ardhurave ose të shkurtojnë kostot, ndërsa vetëm 20 për qind mendojnë të marrin kredi bankare si opsioni i tyre i parë (Figura 5).

**Figura 3. Si po Reagojnë Kompanitë ndaj Rënies së Aktivitetit të Biznesit, Përqindje**



Burimi: Sekretariati i KI.

**Figura 4. Problemet Kryesore të Raportuara nga Firmat, Përqindje**




Burimi: Sekretariati i KI.

<sup>7</sup> 82 për qind e të anketuarve operojnë në sektorin e shërbimeve, 10 përqind në industrinë prodhuese, 5 përqind në sektorin e ndërtimit dhe 2 përqind në bujqësi (Figura A2.1).

<sup>8</sup> KI e ka mbajtur hapur anketën dhe numri i përgjigjeve po rritet gjithnjë e më shumë. Ndërsa kriza vazhdon, ka të ngjarë që përgjigjet të tregojnë efekte negative edhe më të forta. Analiza bazohet në të dhëna të disponueshme deri më 9 Maj, 2020.

**Figura 5. Masat e Planifikuara nga Bizneset për të Siguruar Mbijetesën**



Burimi: Sekretariati i KI.

**16. Goditjet në anën e ofertës nuk kanë qenë dhe aq të rënda sa ato në kërkesë.** Ndonëse vetëm 8 për qind e firmave të anketuara kanë vijuar të funksionojnë me kapacitet të plotë, kompanitë nuk mendojnë se tronditjet në ofertë janë aq serioze sa rënia e kërkesës. Siç tregohet edhe në Figurën 4, vetëm 15 për qind e të anketuarve raportuan si probleme më kryesore ato të lidhura me ofertën që përfshijnë: probleme në organizimin e punës (7 për qind), ulja e produktivitetit të forcës së punës (4 për qind) ose mungesa e lëndës së parë (4 për qind). Megjithatë 55 për qind e firmave që mbështeten në importin e lëndëve të para kanë hasur probleme.

### 3 Bosnjë-Hercegovina

#### 3.1 Vrojtimit Aktuale<sup>9</sup>


**24. Situata paraqitet e rëndë për firmat në Bosnjë-Hercegovinë, ku më të prekurat nga kriza janë firmat mikro.** Sipas anketës së Fondacionit 787, deri më 11 Prill, 72.7 për qind e firmave të anketuara kishin ndërprerë veprimtarinë, ndërsa 16.4 për qind e tyre kishin zgjedhur një mënyrë alternative të bërit biznes me qëllim që të qëndronin aktiv. Rreth 71.5 për qind e të anketuarve gjithashtu raportuan se kriza kishte ndikuar negativisht në biznesin dhe të ardhurat e tyre. Afro 11 për qind e të anketuarve deklaruan se ishin detyruar të çregjistrojnë të punësuarit ndërsa 51.9 për qind u shprehën se mund ta bënin një gjë të tillë së afërmi (Figura 6). Kjo do të përkeqësonte nivelet aktualisht të larta të papunësisë strukturore në vend. 72.4 për qind e firmave mikro raportuan se efektet e krizës kanë qenë jashtëzakonisht të rënda për ta, krahasuar me 67.5 për qind të bizneseve të vogla dhe 57.1 për qind të ndërmarrjeve të mesme. Dhe për të përballuar këtë situatë, gati 63 për qind e tyre kanë vonuar pagesat për shlyerjen e detyrimeve ndaj qeverisë (Figura 7).

**25. Rënia e kërkesës përbën shqetësim serioz.** Pyetjes për të identifikuar tre problemet kryesore, 71.2 për qind e të anketuarve i është përgjigjur me rënien e kërkesës, 10.4 përqind përmendën uljen e eksporteve (Figura 8), ndërsa 27.5 për qind e tyre u shprehën se nuk ishin në gjendje të mblidhnin pagesat nga bizneset e tjera përgjatë zinxhirit të vlerës.

**26. Faktorët që kanë ndikuar në rënien e ofertës nuk konsiderohen aq seriozë sa tronditjet e kërkesës.** Vetëm 10.4 për qind e firmave kanë përmendur mungesën e lëndës së parë dhe uljen e prodhimit si shqetësimin e tyre kryesor, ndërsa 13.6 për qind raportuan vështirësi në riorganizimin e punës së tyre (Figura 8).


<sup>9</sup> Retail and ëholesale constitute the largest share of surveyed firms, 20.1 percent, folloëed by accommodation and food services, 14 percent; professional, scientific and technical activities, 13 percent; and manufacturing, 11.6 percent (Figure A2.2).

**Figura 6. Përgjigjet për “Ishit të detyruar të cregjistrorit për kohësisht punonjësit tuaj?”, Në përqindje**




Burimi: Fondacioni 787.

**Figura 7. Si po Reagojnë Kompanitë ndaj Rënies së Aktivitetit të Biznesit, Përqindje**



Burimi: Fondacioni 787.

**Figura 8. Problemet Kryesore të Raportuara nga Firmat, Përqindje**



Burimi: Fondacioni 787.

## 4 Kosova

### 4.1 Vrojtimet Aktuale <sup>10</sup>

**27. Gjendja e bizneseve është e rëndë.** Sipas një ankete të zhvilluar nga disa shoqata biznesi <sup>11</sup>, rezulton se 39 për qind e firmave kanë ndërprerë tërësisht aktivitetin, 31 për qind kanë punuar me kapacitet më të ulët, ndërsa 14 përqind kanë vijuar punën me orar të reduktuar (Figura 9). Firmat që kanë ndërprerë totalisht aktivitetin duket se kanë qenë ato më të vogla, pra me më pak se 10 të punësuar, siç raportohet edhe nga 54.4 për qind e të anketuarve në këtë kategori; 29.2 për qind e të gjithë të anketuarve raportuan se kanë reduktuar krahun e punës, megjithëse 0.4 për qind e tyre raportuan rritje (Figura 9).

**28. Dy problemet më të cituara në anketë ishin humbjet financiare, që kanë prekur 69.7 për qind të firmave, dhe mungesa e likuiditetit, 39.5 për qind (Figura 10).** Humbjet financiare janë raportuar nga 76 për qind e bizneseve të tregtisë me pakicë dhe 74.4 për qind e bizneseve të tregtisë me

<sup>10</sup> Rreth 33 përqind e të anketuarve vijnë nga sektori prodhues, 14.8 përqind nga tregtia me pakicë, 13.3 përqind nga tregtia me shumicë, dhe 6.8 përqind nga sektori i ndërtimit (Figura A2.3).


<sup>11</sup> Kjo anketë u autorizua dhe realizua nga Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, Këshillin e Investitorëve Evropianë dhe Klubin e Prodhuesve të Kosovës.




shumicë; këta dy sektorë kanë patur edhe problemet më të mëdha përsa i përket likuiditetit, përkatësisht 45.3 për qind e bizneseve të tregtisë me shumicë dhe 40.6 për qind e atyre me pakicë

**29. Faktorët që kanë ndikuar në rënien e ofertës nuk konsiderohen aq seriozë sa tronditjet e kërkesës.** Ndër shqetësimet kryesore të përmendura nga firmat janë humbja e kapacitetit prodhues - 24.1 për qind, rënia e rendimentit - 35.3 për qind, dhe angazhimi i ulët i punonjësve -22.4 për qind (Figura 10). 35.4 për qind e firmave me 10 deri 49 punonjës kanë deklaruar se problemi i tyre kryesor është kapaciteti prodhues. Nuk është për t'u habitur që këto probleme janë raportuar kryesisht nga firmat e klasifikuara në sektorin e prodhimit,<sup>12</sup> më saktësisht nga 48.1 për qind e të anketuarve në këtë grup.

**Figura 9. Problemet Kryesore të Raportuara nga Firmat, Përqindje**



**Figura 10. Si po Reagojnë Kompanitë ndaj Rënies së Aktivitetit të Biznesit, Përqindje**



## 5 Mali i Zi

### 5.1 Analiza e Perspektivës

**30. Bazuar në të dhënat e vitit 2017, pjesa e shërbimeve që ka të ngjarë të preket drejtpërdrejt nga rënia e turizmit përbën 23 për qind të të punësuarve gjithsej (të numrit total të të punësuarve prej 127,000).** Nëse kësaj shume Ëdo t'i shtonim edhe 6 për qind të të punësuarve në firmat e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm, ajo shkon në 29 për qind. Hotelet, restorantet, baret si dhe aktivitetet e tjera të shitjes me pakicë më përjashtim të bizneseve ushqimore dhe farmacive përbëjnë 19.8 për qind të të punësuarve. Paga mesatare vjetore për punëtor në sektorët e prekur nga masat e izolimit është mesatarisht 5,092 euro (509 euro në muaj). Pjesa dërrmuese e firmave të prekura nga kriza kanë më pak se 50 të punësuar, me një pagë më të ulët vjetore për punonjës prej 5,004 € (417 € në muaj) sipas të dhënave të vitit 2017.

**31. Nisur nga rëndësia që ka turizmi për ekonominë e Malit të Zi, firmat atje ka të ngjarë të goditen më rëndë nga kriza e pandemisë se ato në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.** Të ardhurat nga turizmi përbëjnë rreth 21 përqind të PBB-së së Malit të Zi, krahasuar me 7.2 përqind në Maqedoninë e Veriut dhe 6.9 përqind në Serbi.<sup>13</sup> Në vitin 2019, vetëm shërbimet e akomodimit dhe

<sup>12</sup> Përbërja e saktë e këtij sektori është e paqartë.

<sup>13</sup> Vetëm në Shqipëri këto të ardhura kanë një peshë më të madhe, 27.3 përqind.

ushqimit kishin mbi 15,000 të punësuar, që përbën mbi 10 përqind të të punësuarve formalë në sektorin privat.

## 6 Maqedonia e Veriut

### 6.1 Analiza e Perspektivës

**32. Ndikimet e krizës së Covid-19 në ekonominë e Maqedonisë së Veriut pritet të ndihen jo vetëm në sektorin e shërbimeve, por edhe atë prodhues, veçanërisht për mallrat e qëndrueshëm, veshjet dhe tekstilet.** Këta dy nënsektorë prodhues kanë edhe numrin më të lartë të të punësuarve si dhe shpenzimet më të mëdha vjetore për paga në krahasim me të gjithë sektorët e tjerë të prekur. Gjithashtu dhe tregtia me pakicë e artikujve jo-jetik, me një numër të lartë të të punësuarve, që arrin deri në rreth 70 përqind të atyre të punësuar në sektorin e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm, do të goditet rëndë si pasojë e mbyljes së aktivitetit (shiko Shtojcën 1 për industrinë që bëjnë pjesë në këtë sektor). Kontributi i sektorëve më të prekur (d.m.th. të ndjeshëm ose të mbyllur) në nivelin e përgjithshëm të punësimit dhe faturës së pagave është si më poshtë:

- a. **Firmat e veshjeve, tekstileve dhe ato të prodhimit të mallrave të qëndrueshëm përbëjnë së bashku pak më shumë se 20 përqind të numrit total të të punësuarve të raportuar në vitin 2016.** Nga 396.770 që është numri total i fuqisë punëtore në vend, 10.6 përqind janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe tekstileve, ndërsa 10 përqind në industrinë e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm. Përveç këtyre, 6.9 përqind janë të punësuar në tregtinë e artikujve jo-jetik, dhe 6.5 përqind në shërbime ushqimore, udhëtim dhe akomodim. Kështu që ekonomia e Maqedonisë së Veriut është e ekspozuar ndaj krizës përmes disa sektorëve. Një nga shqetësimet është se firmat që janë prekur më shumë kanë më pak se 50 të punësuar duke qenë në këtë mënyrë edhe më të ekspozuara ndaj krizës.
- b. **Fatura totale vjetore e pagave për industrinë e veshjeve dhe tekstileve është 244 milionë euro.** Ndonëse industria e prodhimit të mallrave të qëndrueshëm zë vendin e dytë përsa i përket numrit të të punësuarve, ajo zë vendin e parë ndër sektorët më të ekspozuar përsa i përket pagave, me një faturë totale të pagave që arrin në 131.5 milionë euro. Shuma totale për shërbimet ushqimore, udhëtimin dhe akomodimin të marra sëbashku është 60 milionë euro. Të gjithë sektorët potencialisht të prekshëm përbëjnë gati një të tretën e faturës vjetore të pagave të vendit (400 milionë euro nga 1.26 miliardë euro).

### 6.2 Vrojtimet Aktuale<sup>14</sup>

**33. Kriza ka prekur tashmë rëndë bizneset në Maqedoninë e Veriut.** Sipas anketës së Institutit Finance Think, rreth 41.5 përqind e bizneseve u detyruan të mbyllin aktivitetin për shkak të masave kufizuese dhe 43.1 përqind kishin pritshmëri për një rënie të konsiderueshme të të ardhurave (Figura 11). Ndikimi në firmat mikro ka qenë veçanërisht i fortë ku pjesa e të anketuarve që u detyruan të mbyllin aktivitetin është 8 pikë përqindje mbi mesataren dhe e atyre me rënie të konsiderueshme të të ardhurave 12 pikë më e lartë. Megjithatë, anketa e Dhomës Ekonomike tregon se 72 përqind e të anketuarve nuk mendonin të mbyllnin kompaninë, ndërsa 21 përqind e tyre mendonin mbyllje të pjesshme të aktivitetit (Figura 12).


---

<sup>14</sup> 46 përqind e firmave të anketuara ishin në sektorin e industrisë dhe ndërtimit, 40 përqind në turizëm dhe mikpritje, 7 përqind në tregti, dhe 7 përqind në sektorin e shërbimeve dhe bujqësi (Figura A2.4).

**34. Tronditjet në kërkesë kanë qenë shumë të ndjeshme.** Të dhënat e Dhomës Ekonomike tregojnë se 81 përqind e bizneseve kanë patur rënie të të ardhurave si rezultat i anulimit të punës së kontraktuar, ndërsa rreth një e treta u shprehën se humbjet arrinin në mbi 50 përqind. Sipas anketës së Institutit Finance Think, 21.5 përqind e firmave kanë deklaruar se kishin probleme me shitjet (Figura 11) ndërsa sipas anketës së Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, 59 përqind e kompanive të reja (start-ups) kanë identifikuan kërkesën si faktor rreziku.


**35. Goditjet në anën e ofertës siç janë kufizimet në punë ose mungesa e lëndës së parë nuk kanë qenë pengesë madhore për bizneset.** Sipas Dhomës Ekonomike, vetëm 19 përqind e firmave kanë aplikuar lejen e detyrueshme për punëtorët e tyre (Figura 13) dhe vetëm 0.8 përqind kanë pushuar punonjësit. Ky rezultat nuk përputhet me uljet e raportuara të të ardhurave ndërsa firmat përballen me mungesën e likuiditeti dhe pamundësinë për të marrë kredi (Figura 14). Ka mundësi që firmat ta kenë të vështirë të bëjnë pushime nga puna ose anketa ka qenë e paqartë. Sidoqoftë, një nga masat e para që ka marrë qeveria ka qenë programi i subvencionimit të pagave<sup>15</sup>. Sipas anketës së Institutit Finance Think, vetëm 13.8 përqind e firmave kanë hasur probleme në sigurimin e lëndës së parë (Figura 11). Po kështu, sipas anketës së Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, zinxhirët e furnizimit nuk konsiderohen si faktor kryesor risku, duke u raportuar vetëm nga 39 përqind e bizneseve.

**Figura 11. Problemet Kryesore të Raportuara, Të Gjitha Firmat, Përqindje**



Burimi: Anketa e Institutit Finance Think.


**Figura 12. Përgjigjet për "A mendoni të mbyllni biznesin tuaj?", Në Përqindje**



Burimi: Anketa e Dhomës Ekonomike të Maqedonisë.


<sup>15</sup> Në muajin Prill 21,030 kompani (1/3 e të gjitha kompanive në vend), me 139,437 të punësuar (1/3 e të punësuarve gjithsej në sektorin privat) morën subvencione në vlerën e pagës minimale neto dhe/ose 50% të kontributeve të sigurimeve shoqërore. 59% e të punësuarve që kanë përfituar këtë pagesë punojnë në ndërmarrjet mikro dhe të vogla (deri në 50 të punësuar), 21% në ndërmarrjet e mesme (me 50-250 të punësuar) dhe 20% në kompanitë e mëdha (mbi 250 të punësuar). Vlera totale e këtyre subvencioneve e tejkalon shumë dhe 27.6 milionë eurove.

**Figura 13. Si po Reagojnë Kompanitë ndaj Rënies së Aktivitetit të Biznesit, Përqindje**



Burimi: Anketa e Dhomës Ekonomike të Maqedonisë.

**Figura 14. Probleme me Likuiditetin, Përqindje**



Burimi: Anketa e Dhomës Ekonomike të Maqedonisë.

## 7 Serbia

### 7.1 Analiza e Perspektivës

**36. Kriza e Covid-19 pritet të ndikojë ekonominë e Serbisë kryesisht përmes sektorit të prodhimit, ku veçanërisht të rëndësishëm janë eksportet dhe mallrat e qëndrueshëm.** Pjesa më e madhe e punëtorëve në sektorët që potencialisht do të preken nga kriza, janë të punësuar në sektorin e prodhimit për eksport. Rënia e kërkesës për eksporte e shoqëruar me problemet në logjistikë, p.sh. për importimin e materialeve, mund të krijojë një efekt të ndjeshëm negativ. Gjithashtu, kërkesa për mallra të qëndrueshëm ka tendencë të pësojë rënie të konsiderueshme gjatë krizave. Pothuajse gjysma e të gjithë të punësuarve në kompanitë eksportuese punojnë për prodhimin e mallrave të qëndrueshëm, dhe 86 përqind e prodhuesve të mallrave të qëndrueshëm janë edhe eksportues, dhe kjo pritet të rrisë efektet e mundshme negative të krizës. Për sa i përket shërbimeve, sektori i prekur ku janë të punësuar shumica e punëtorëve është ai i tregtisë me pakicë të artijkuje jo-jetike.<sup>16</sup> Sidoqoftë, numri i të punësuarve në këtë sektor është vetëm sa rreth një e teta e numrit të të punësuarve formalë në sektorin e prodhimit për eksport:

- Në vitin 2017 prodhuesit e eksporteve punësuan mbi 25 përqind të totalit të të punësuarve formalë, pa përfshirë pronarët e vetëpunësuar të bizneseve.** Të dhënat e disponueshme i referohen 1 milion të punësuarve formalë (përfshirja e pronarëve të vetëpunësuar do të rriste me 1.1 milion këtë shifër), ku 26.4 përqind e tyre janë të punësuar në prodhuesit e eksporteve, ndërsa 12.5 përqind në eksportuesit e mallrave të qëndrueshme. Në sektorin e shërbimeve janë të punësuar më pak njerëz, por në nivel të mjaftueshëm që të krijojë efekte negative për 90,000 të punësuar në aktivitetet e shërbimit ushqimor dhe akomodimit dhe 120,000 në shërbimet e transportit. Për më tepër, shumica e kompanive të prekura kanë më pak se 50 të punësuar.
- Shpenzimet totale për paga të prodhuesve eksportues janë rreth 2.5 miliardë euro.** Megjithatë, totali i shpenzimeve për paga në të gjithë sektorët e rrezikuar të shërbimeve, prodhimin e mallrave të qëndrueshëm dhe veshjeve dhe tekstilit (pavarësisht nga statusi i eksportit) arrin në rreth 2.2 miliardë euro. Shpenzimet totale për paga për prodhimin e gjithë mallrave të qëndrueshëm janë 1.3 miliardë euro, ndërsa për prodhimin e mallrave të qëndrueshëm për eksport shpenzimet për

<sup>16</sup> Industritë që bëjnë pjesë në këtë sektor janë dhënë në Aneksin 1.

paga janë 1,15 miliardë euro. Për krahasim, shpenzimet për paga në sektorin e tregtisë me pakicë të artikujve jo jetikë janë vetëm 0.25 miliardë euro. Prandaj, ndjeshmëria e Serbisë ndaj krizës vjen kryesisht nga sektori i madh i prodhimit të saj dhe më pak nga shërbimet e prekura nga mbyllja.

## 7.2 Vrojtimet Aktuale <sup>17</sup>

**37. Në Serbi, kriza ka goditur më rëndë sektorin e shërbimeve dhe biznesin e vogël.** Siç paraqitet në Figura 15, 22 përqind e të anketuarve i kanë mbyllur përkohësisht të gjitha aktivitetet, dhe 26.5 përqind e tjerë i kanë mbyllur pjesërisht ato. Më shumë se gjysma e të anketuarve kishin pritshmëri që të ardhurat e tyre në Mars 2020 të binin me më shumë se 50 përqind krahasuar me 2019-ën. Një e treta e kompanive deklaruan se rënia në të ardhura pritej të ishte më e madhe se 80 përqind. Sipas të dhënave të anketimit të kryer nga Dhoma e Tregtisë Serbe dhe USAID situata është më e rëndë në sektorin e turizmit dhe të mikpritjes. Rreth 35 përqind e sipërmarrësve të vetëpunësuar dhe mikro-biznesit gjithashtu prisnin që të ardhurat e tyre në Mars të binin me më shumë se 80 përqind krahasuar me Marsin 2019. Ndërkohë, vetëm 7.2 përqind e të anketuarve të biznesit të mesëm (me 250 ose më pak të punësuar) dhe 15.4 përqind e të anketuarve nga biznesi i madh kishin pritshmëri për rënie të tilla të mëdha të të ardhurave.


**38. Ulja e kërkesës përbën problemin më të madh me të cilin ndeshen të gjitha kompanitë Serbe, por ky problem është më pak shqetësues për sektorin e prodhimit industrial (Figura 16).** Për sa i përket intensitetit të rënies së kërkesës sipas një shkalle vlerësimi nga 1 deri në 5 (më i lartë), sektori i turizmit pati rezultatin më të lartë mesatar me shkallën 4.3. Thelbësore për Serbinë, rezultati mesatar për rënien e kërkesës për kompanitë prodhuese ishte në nivelin 3.6. Megjithëse i lartë, vetëm bujqësia dhe TIK raportuan intensitet më të ulët të rënies së kërkesës se ky nivel.

**39. Problemet më të mëdha në anën e ofertës raportohen të jenë kufizimet në kohën e punës dhe punën nga shtëpia; pamundësia për të importuar ka pasur vetëm efekte të kufizuara (Figura 16).** Sidoqoftë, vetëm 5.1 përqind e kompanive kanë hequr nga puna një pjesë apo të gjithë punonjësit e tyre (Figura 15). Kompanive të anketuara iu kërkua gjithashtu të vlerësojnë intensitetin e sfidave të ndryshme në një shkallë nga 1–5 (më e larta). Në lidhje me kufizimet e diskutuara të ofertës së punës, efektet më të forta vlersohet të jenë në turizëm (me intensitet mesatar 4,5) dhe shërbime të tjera (intensitet mesatar 3.8), e ndjekur nga industria dhe prodhimi (mesatarisht 3.6). Është interesante se shumica e firmave, përveç atyre që operojnë në sektorë të lidhur me tregtinë, nuk ishin prekur ndjeshëm nga pamundësia për të importuar. Firmat tregtare raportojnë një intensitet mesatar prej 3.4 për problemin me importet, të ndjekura nga industria dhe prodhimi me intensitet të shkallës 2.7.

---


<sup>17</sup> 31 përqind e firmave të anketuara ishin në prodhim, 17 përqind në tregti, 18 përqind në shërbime profesionale dhe administrative, dhe 15 përqind në shërbime të tjera (Figura A2.5).

**Figura 15. Si po Reagojnë Kompanitë ndaj Rënies së Aktivitetit të Biznesit, Përqindje**



Burimi: Dhoma e Tregtisë së Serbisë dhe USAID.

**Figura 16. Problemet Kryesore të Raportuara nga Firmat me 5 ose më Pak të Punësuar, Përqindje**



Burimi: Dhoma e Tregtisë së Serbisë dhe USAID.

## 8 Udhëzime për Politika me Bazë të Gjerë

**40. Firmat do të duhet të përshtatin modelet e tyre të biznesit me normalitetin e ri.**<sup>18</sup> Në përgjithësi, kjo lloj krize ka dy faza, shpërthimin dhe rimëkëmbjen. Megjithatë, për shkak të rrezikut nga valë të tjera të Covid-19, këto dy faza mund të ripërsëriten. Gjatë fazes së parë, është e nevojshme të garantohet vijëmbësia e aktivitetit me mbështetje të menjëhershme, veçanërisht për firmat e shëndetshme për të mbajtur burimet dhe talentin e tyre njerëzor, në mënyrë që ata të mund të kthehen shpejt në nivelet e tyre para krizës në fazën e rimëkëmbjes. Megjithatë, për të dy fazat, firmat duhet të bëjnë rregullime strukturore në tre fusha për të garantuar mbijetesën: (1) sigurimi i pajtueshmërisë me udhëzimet shëndetësore, siç është distancimi social; (2) adoptimi i teknologjisë dixhitale për të mundësuar kryerjen e punës nga shtëpia dhe shpërndarjen në distancë të shërbimeve për konsumatorët; dhe (3) aksesin në inputet dhe tregjet ndërkombëtare pas ndërprerjeve të pashmangshme, të cilat do të kërkojnë rregullime krijuese.

**41. Politikëbërësit duhet të ofrojnë si mbështetje financiare ashtu dhe për zhvillim të biznesit për t'i ndihmuar firmat të përshtaten me modelet e reja të biznesit.** Për këtë, aksesin në financim duhet të përqendrohet jo vetëm në zgjidhjen e problemeve të likuiditetit, por edhe në sigurimin e flukseve të mjaftueshme financiare në drejtime potencialisht me risk të përdorimit të teknologjisë dhe inovacionit. Pasiguria e krijuar nga kriza Covid-19 mund të përkeqësojë aksesin në kreditim të sektorit privat. Ndër përgjigjet e politikave janë garancitë për kreditë dhe zgjerimi i programeve të faktorizimit të kredive. Për ta plotësuar këtë, shërbimet e mbështetjes për zhvillimin e biznesit dhe inovacioni dhe mbështetja e sipërmarrjes mund të udhëheqin firmat përmes modeleve dhe teknologjive të reja të biznesit duke ofruar askes në konsulentë, përvojë dhe ekspertizë.

<sup>18</sup> Rekomandimet lidhur me masat që mund të ndërmarrin qeveritë e vendeve për të mbështetur firmat dhe punonjësit mund të gjenden në dokumentet e tjera shoqëruese të RER-it: “Dobësitë e Sektorit Financiar, Zbutja e Ndikimeve dhe Opsionet e Politikave”; “Kundërpërgjigjet e Mbrojtjes Sociale ndaj Covid-19 në Ballkanin Perëndimor”; dhe “Politika Fiskale për Rrafshimin e Kurbave: Kufizimi dhe Zbutja e Efekteve të Krizës.”

# **Aneks 1. Klasifikimi i Shërbimeve të Mbyllura (Vavra 2020) dhe Përkufizimi i Mallrave të Qëndrueshëm**

Kodet numerike të aktiviteteve të referuara më poshtë janë sipas klasifikimit të NAICS.

## **Shërbime ushqimi dhe pije**

7223 Shërbime të Vecanta Ushqimore  
7224 Vende të Shërbimit të Pijeve (Pije Alkoolike)  
7225 Restorante dhe Vende të Tjera të Shërbimit Ushqimor

## **Udhëtim (transport dhe hoteleri)**

4811 Transport Ajror i Skeduluar  
4812 Transport Ajrori Jo i Skeduluar  
4853 Shërbime të Transportit me Taksi dhe Limuzinë  
4854 Transporti me Autobus për Shkolla dhe për Punonjës  
4859 Transport Tjetër Rrugor për Pasagjerë dhe Tranzit  
4881 Aktivitete Mbështetëse për Transportin Ajror  
4883 Aktivitete Mbështetëse për Transportin Ujor  
7211 Akomodim i Udhëtarëve

## **Aktivitete të shërbimeve personale**

6212 Klinika Dentare  
8121 Shërbime të Kujdesit Personal  
8129 Shërbime të Tjera Personale

## **Aktivitete krijuese, çlodhëse dhe arte**

7111 Shfaqje Artistike  
7112 Aktivitete Sportive me Spektatorë  
7115 Artistë, Shkrimtarë dhe Performues të Pavarur  
7131 Aktivitete të Parqeve të Argëtimit dhe Atyre me Orientim të Caktuar  
7132 Industritë e Lojrave të Fatit  
7139 Aktivitete të Tjera Argëtimi dhe Çlodhëse

## **Tregtia me pakicë e artikujve jo jetikë**

4411 Dyqanet e Shitjes së Automjeteve  
4412 Dyqane të Mjeteve të Tjera Motorike  
4421 Dyqanet e Mobiljeve  
4422 Dyqanet e Pajisjeve Shtëpiake  
4481 Dyqanet e Veshjeve  
4482 Dyqanet e Këpucëve  
4483 Dyqanet e Argjendarive, Valixheve dhe Artikujve prej Lëkure  
4511 Dyqane të Produkteve Sportive, Kohës së Lirë dhe të Instrumenteve Muzikorë  
4512 Dyqanet e Librave dhe Gazetave  
4522 Mapo Industriale  
4531 Dyqanet e Luleve  
4532 Pajisje për Zyra, Kancelari dhe Dyqanet e Dhuratave  
4539 Dyqane për Artikuj të Ndryshëm  
5322 Qiradhënia e Mallrave të Konsumit  
5323 Qendra për Qiradhënie të Përgjithshme  
4243 Shitje më Shumicë të Veshjeve, Metrazheve dhe Kinkalërive për Tekstile  
4413 Dyqane të Pjesëve të Këmbimit, Aksesorë dhe Goma të Automjeteve  
4543 Aktivitetet e Shitjes së Drejtpërdrejtë

## **Prodhimi i Mallrave të Qëndrueshëm Durable Manufacturing**


321 Prodhimi i Produkteve prej Druri  
327 Prodhimi i Produkteve Minerale Jo Metalike  
33 Prodhimi i Produkteve të Tjera

## **Veshje dhe Tekstile**

313 Prodhimi i Tekstileve  
314 Prodhimi i Produkteve të Tekstileve  
315 Prodhimi i Veshjeve  
316 Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkure


## Aneks 2. Shpërndarja e të Anketuarve sipas Sektorëve në Vendet e Rajonit

**Figura A2.1. Shpërndarja sipas Sektorëve, Shqipëria, Në Përqindje**




Burimi: Sekretariati i KI.

**Figura A2.2. Shpërndarja sipas Sektorëve, Bosnja dhe Hercegovina, Në Përqindje**




Burimi: Fondacioni 787.

**Figura A2.3. Shpërndarja sipas Sektorëve, Kosova, Në Përqindje**



Burimi: RECURA.


**Figura A2.4. Shpërndarja sipas Sektorëve, Maqedonia e Veriut, Në Përqindje**



Burimi: Anketa e Dhomës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut



**Figura A2.5. Shpërndarja sipas Sektorëve, Serbia, Në Përqindje**



*Burimi:* Dhoma e Tregtisë së Serbisë dhe USAID.